



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 1367/2024

Datë: 27 dhjetor 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, nenit 22 paragrafët 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 19 paragrafit 9 si dhe nenit 24 paragrafit 3 të Rregullores Nr.07/2024 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës, në takimin e mbajtur më datë 27 dhjetor 2024, mori këtë:

VENDIM

1. Z. Agron Bajrami, prokuror në Prokurorinë e Apelit, emërohet Kryeprokuror i Prokurorisë së Apelit.
 2. Mandati i z. Bajrami fillon nga data 27 dhjetor 2024 për periudhën katër (4) vjeçare me mundësi vazhdimi edhe për një mandat shtesë.
 3. Z. Bajrami, pas përfundimit të mandatit si Kryeprokuror, do të vazhdojë punën në pozitën e prokurorit në prokurorinë ku ka shërbyer si prokuror i Prokurorisë së Apelit.
 4. Obligohet z. Bajrami që detyrat dhe përgjegjësitë t'i ushtrojë në bazë të legjislacionit në fuqi.
 5. Z. Bajrami ka të drejte në shfrytëzimin e beneficioneve që rrjedhin nga ushtrimi i pozitës së Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit.
 6. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.



Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Z. Agron Bajrami, prokuror në Prokurorinë e Apelit;
- Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit;
- Sekretariatit dhe Dosjes së Prokurorëve;
- Arkivit të KPK-së.